



BULETIN

3- MUJOR/NR. 17
KORRIK - SHTATOR
2006

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Nr. 17

KORRIK - SHTATOR 2006

PASQYRA E TITUJVE

KRYESORË :

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE - fq 2
2. OFRIM EKSPERTIZE LIGJORE - fq 3
3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNESE - fq 3
4. VEPRIMTARI SENSIBILIZUES & NDËRORGJESUES - fq 5
5. PROJEKTE TË REJA - fq 6
6. TRYEZA DHE KONFERENCA - fq 6
7. SHITETA SIT I DREJTOREN KSHH-SË - fq 7
8. REAGJIME PUBLIKE TË KSHH-SË - fq 9
9. KOMUNIKIME ME AUTORITETE SHITËTORE & ORGANIZATA - fq 9
10. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS - fq 10

Përgatiti buletinin: **Dr. Erida SALIU**

Juriste/Koordinatorë projekti

Edheaktualizuarat: **Maria MATO**

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikim dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID "CATHOLIC ORGANIZATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT"

Respektimi i të drejtave të të dënuarve

Në muajt Korrik-Shtator 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi misione vëzhgimi në disa institucione paraburgimi Nr. 313, 302 në Tiranë, në paraburgimin e Vlorës dhe të Ieshës, në dhomat e paraburgimit të Komisariateve të Policisë Shkodër, Krujë, Burrel, Korçë, Elbasan, Pogradec, Fier si edhe I ushje. Qëllimi i tyre ishte monitorimi i situatës së respektimit të të drejtave të të paraburgosurve, i kushteve dhe trajtimit të tyre nga administrata e institucioneve si edhe identifikimi i shkeljeve dhe mangësive ligjore që i shkaktojnë ato.

Vazhdon në faqen 2

Ofrim ekspertize dhe opinionesh ligjore

Minoritetet dhe respektimi i të drejtave të tyre

Qeveria shqiptare përgatiti raportin e II të për zbatimin e Konventës-Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve kombëtare.

KSHH-ja u ftua të japi ekspertizën lidhur me draft raportin. KSHH dha komentet dhe opinionet e tij të cilat i janë dërguar Ministrisë së Jashtme duke synuar pasqyrimin sa më objektiv të respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri si dhe kontributet e shoqërisë civile dhe problemet e minoritetit rom dhe egjiptian.

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. Gjin Bue Shpata; Pall. 5/L,
Ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
web-site: www.shco.org.al

Tel: 04 233671
Cel: 068 20 23 699;
E-mail: office@shco.org.al

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

1.1 Misione të planifikuara vëzhgimesh në vendet e paraburgimit¹

Në muajt korrik-shtator 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi misione vëzhgimi në disa institucione paraburgimi: në institucionet nr. 313, 302 në Tiranë, në paraburgimin e Vlorës dhe të Lezhës, në dhomat e paraburgimit të komisariateve të policisë të Shkodrës, Krujës, Burrelit, Korçës, Elbasanit, Pogradecit, Fierit dhe Lushnjës. Qëllimi i tyre ishte monitorimi i situatës së respektimit të të drejtave të të paraburgosurve, i kushteve dhe i trajtimit të tyre nga administrata e institucioneve si edhe identifikimi i shkeljeve dhe i mangësive ligjore që i shkaktojnë ato.

Gjatë vëzhgimeve rezultoi se të drejtat e të paraburgosurve cenoheshin rëndë si pasojë e mbipopullimit, infrastrukturës dhe kushteve higjieno-sanitare mjaft të këqija, mungesës së plotë të barnave mjekësore, mungesës së klasifikimit të të paraburgosurve në bazë të moshës, veprës penale të kryer, veçorive të personalitetit të tyre, mbajtjes së personave me vendim gjykate të formës së prerë në vendet e paraburgimit etj. KShH-ja reagoi nëpërmjet një deklarate publike duke u tërhequr edhe një herë vëmendjen institucioneve përgjegjëse shtetërore për marrjen e masave urgjente për përmirësimin e gjendjes, për respektimin e të drejtave të të paraburgosurve në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar dhe për t'u dhënë fund shkeljeve të konstatuara².

1.2 Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë në pikat e kalimit të kufirit në fokusin e KShH-së³

Në datat 28-30 shtator 2006, KShH-ja organizoi vëzhgime në tri pika kryesore të kalimit kufitar me Greqinë, përkatësisht në: Kapshticë (Korçë), Tri Urat (Përmet) dhe Kakavijë (Gjirokastrë). Nga kontaktet me oficerët drejtues të policisë kufitare në këto pika si dhe nga vëzhgimi i kryer u konstatua se vazhdonte kthimi i shtetasve shqiptarë nga policia greke, mesatarisht rreth 150-200 persona në ditë. Të kthyerit ishin pothuajse pa dokumentacion të rregullt, me viza të skaduar ose pa viza.

Rastet e vetme të anomalisë krijoheshin në rastet e festave ose të pushimeve, për shkak fluksit të madh të personave që kalonin kufirin.

Gjatë vëzhgimit u vu re se infrastruktura në këto pika kufitare ishte përmirësuar, por ende kishte mungesa të stafit femër.

1.3 Respektimi i të drejtave të minoriteteve në qytetin e Korçës⁴

Në kuadër të rritjes së aksesit të minoriteteve te organet e administratës publike vendore përfundoi anketimi i administratës së bashkisë së Korçës, i studentëve, qytetarëve, përfaqësuesve të minoritetit, rretheve intelektuale, OJF-ve që veprojnë në Korçë etj.

Pas përpunimit të të dhënave të pyetësorëve, filloi përgatitja e raportit i cili do të diskutohet në këshillimin bashkiak dhe organet e tjera vendore.

¹ Këto vëzhgime u realizuan në kuadër të projektit “Drejtimi i vendeve të paraburgimit sipas këndvështrimit të të drejtave të njeriut”, mbështetur financiarisht nga ambasada amerikane.

² Për më shumë, shih shtojcën nr.1 për deklaratat dhe njoftimet për shtyp që KShH-ja ka bërë gjatë kësaj periudhe, si dhe faqen tonë të internetit www.ahc.org.al

³ Këto vëzhgime u zhvilluan në kuadër të projektit “Për respektimin e të drejtave të emigrantëve dhe të personave të kthyer”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

⁴ Ky proces zhvillohet në kuadër të zbatimit të projektit “Ushtrimi i të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”, mbështetur financiarisht nga Friedrich Ebert Stiftung

2. OFRIM EKSPERTIZE NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TIJ

2.1 Ofrim ekspertize dhe oponenca ligjore

- **Minoritetet dhe respektimi i të drejtave të tyre**

Qeveria shqiptare përgatiti raportin II për zbatimin e konventës-kuadër “Për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”.

KShH-ja u ftua të japë ekspertizën për projektraportin. Ai dha komentet dhe opinionet e tij të cilat i janë dërguar Ministrisë së Jashtme. Në to është synuar pasqyrimi sa më objektiv i respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri si dhe kontributet e shoqërisë civile për problemet e minoritetit rom dhe atij egjiptian.

- **Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut**

KShH-ja ka shprehur opinione për disa çështje që kanë të bëjnë me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në pyetësor janë trajtuar çështje të të drejtave të njeriut lidhur me mjetet e rekursit vendës, problemet e gjyqësorit në Shqipëri, ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut etj.

- **Reforma zgjedhore për të drejtat e vëzhguesve në proces**

Me qëllim përmirësimin e Kodit zgjedhor dhe rritjen e rolit të organizatave vëzhguese në vëzhgimin e zgjedhjeve, KShH-ja u dërgoi një letër bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore në të cilën rekomandon përmirësimin e legjislacionit zgjedhor për akreditimin e OJF-ve në vëzhgimin e procesit zgjedhor. Nisma e mësipërme u ndërmorë nisur nga përvoja e zgjedhjeve parlamentare të një viti më parë. Në këto zgjedhje, KQZ-ja ua reduktoi organizatave jofitimprurëse kohën e akreditimit për monitorimin e procesit zgjedhor, duke ua kufizuar në këtë mënyrë mundësinë e monitorimit të procesit zgjedhor.

- **Trajtimi i barabartë para ligjit i personave të paraburgosur**

Me gjithë zhvillimet pozitive të bëra në fushën e paraburgimit, KShH-ja ka shprehur shqetësim për Rregulloren e re të të paraburgosurve, miratuar nga Ministria e Drejtësisë, pasi, nga formulimi i nenit 73 të saj, lihet vend për diskutim në lidhje me zbatimin e disa rregulloreve për institucionet e paraburgimit nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe atyre nën varësinë e Ministrisë së Brendshme. KShH-ja është e mendimit se, për të gjitha vendet e paraburgimit, duhet të ketë një rregullore të vetme, e miratuar kjo nga Ministria e Drejtësisë, dhe trajtimi i të paraburgosurve të jetë i njëjtë.

3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE

- **Trajnim trajnerësh shqiptarë të administratës së burgjeve⁵**

⁵ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KSHH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe njohja e tyre me të drejtat e njeriut, si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

Në kuadër të mbështetjes dhe të kontribuimit në procesin e rritjes së kapaciteteve profesionale të administratës së burgjeve, në datat 11-14 shtator 2006, KShH-ja organizoi aktivitetin “Trajnim trajnerësh”⁶. Qëllimi i aktivitetit ishte krijimi i një grupi trajnerësh lokalë që do të shërbejnë për trajnimin në të ardhmen të administratës së burgjeve si edhe përgatitja e një programi mësimor për çështje të tilla, si: komunikimi, të dënuarit në pozita të dobëta, siguria dhe kontaktet me botën e jashtme. Në grupin e trajnerëve shqiptarë merrnin pjesë 12 specialistë të sektorit të edukimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga qendra e trajnimit të administratës së burgjeve, të cilët u trajnuan nga tre ekspertë të huaj⁷ me përvojë të pasur në fushën e sistemit penitenciar si dhe në trajnimin e administratës së burgjeve.

Temat e trajtuara, si: komunikimi, kontaktet me botën e jashtme, siguria dhe trajtimi i veçantë i të dënuarve në pozita të dobëta, u panë nga praktika të mirëmenaxhimit të burgjeve shqiptare sipas standardeve të kërkuara të respektimit të të drejtave të njeriut.

Pjesëmarrësit e vlerësuan trajnimin për vlerat teorike dhe praktike të tij, për metodologjinë e trajtuar, dobishmërinë dhe përvojat e sjella nga ekspertët.

- **Sesioni i pestë i punës me administratën e burgut të Lezhës⁸**

Në datat 10-11 korrik 2006, KShH-ja organizoi sesionin e pestë të punës me administratën e burgut të Lezhës. Objektivat e tij ishin: rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të nivelit të mesëm, sidomos atij me uniformë, në procesin e mirëmenaxhimit të burgut, si edhe vlerësimi i sesioneve të mëparshme të organizuara nga KShH-ja⁹. Sesioni u përqendrua në çështje të rëndësishme, si: roli i stafit të sigurisë të nivelit të mesëm brenda strukturës komunikuese të institucionit, përmeshja e përgjegjësive ndaj të dënuarve, detyrat dhe përgjegjësitë operacionale e ditore të tyre, si edhe roli i stafit bazë.

Pjesë e trajnimit ishte edhe vlerësimi i pesë sesioneve të punës, të zhvilluara nga KShH-ja me administratën e burgut të Lezhës¹⁰. Në përfundim të sesionit të punës, KShH-ja ofroi disa rekomandime specifike për: shmangien e lëvizjeve të vazhdueshme të stafit nga një regjim në tjetrin; rritjen e kontributit të stafit të sigurisë të nivelit të mesëm drejtues në politikat që ndjek institucioni; trajnimet e mëtejshme të stafit të nivelit bazë të institucionit si edhe përfshirjen e testit psikologjik dhe të intervistave gojore në procesin e përzgjedhjes së stafit të ri.

3.2 Këshillime ligjore ofruar të dënuarve në burgje

Gjatë muajit shtator 2006, KShH-ja nisi raundin e dytë të këshillimeve ligjore për të dënuarit në burgjet e Vaqarit, Peqinit, Lezhës dhe në spitalin e burgut. Juristët e KShH-së dhanë këshillime ligjore falas dhe i njohën të dënuarit me të drejtat dhe detyrat e tyre të përcaktuara në ligj.

Përzgjedhja e temave ligjore të diskutuara me të dënuarit në burgje u bazua në nevojat dhe kërkesat e stafit të institucioneve. Këshillimet ligjore u jepen të dënuarve në grup, por, për çështje të veçanta që për ta mund të jenë me interes, u jepen edhe individualisht. Ky shërbim është vlerësuar si shumë i suksesshëm dhe i kërkuar nga të dënuarit.

⁶ Veprimtaria është e dyta për nga lloji që Komiteti Shqiptar i Helsinkit realizon me administratën e burgjeve shqiptare.

⁷ Ekspertët e huaj janë: z. Jan van den Brand⁷, Stef van de Lande dhe Monique Lejenue.

⁸ Ky aktivitet u zbatua në kuadër të projektit të KShH-së “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri-monitorimi i të drejtave të njeriut në burgje dhe vendet e paraburgimit, rritja e ndërgjegjësimit të administratës publike dhe njohja e tyre me të drejtat e njeriut, si edhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁹ Në sesionin e punës u ofrua ekspertizë nga një ekspert i huaj.

¹⁰ 75 për qind e stafit të burgut të Lezhës të trajnuar nga KShH-ja theksuan se kanë përfutuar maksimalisht nga këto sesione pune.

3.3 Ngritje kapacitetesh të korrespondentëve dhe të ekspertëve të KShH-së për studimin e vendimeve penale¹¹

Në datën 22 shtator 2006, KShH-ja organizoi sesionin e trajnimit për studimin e vendimeve penale të formës së prerë me autor të miturin, për vitin 2005 dhe gjysmën e vitit 2006. Metodologjia e studimit dhe e vëzhgimeve si dhe e proceseve gjyqësore me autor të miturin ishin pjesë e këtij trajnimi. Në trajnim morën pjesë juristë të përzgjedhur në rrethet ku u shtri studimi si dhe korrespondentët e KShH-së.

Krahas prezantimit të veprimtarisë së KShH-së dhe objektivave të projektit, u trajtuan një sërë çështjesh, si: udhëzime për zbatimin e neni 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut për një proces të drejtë gjyqësor; udhëzime për parimet procedurale penale, të drejtat e të miturve dhe përfitimet që përcakton ligji procedural penal dhe ai penal për këtë kategori; trajtimi i një sërë kazuesh nga praktika shqiptare dhe ajo ndërkombëtare etj.

Në ndihmë të ekspertëve dhe të korrespondentëve u përgatit edhe një pyetësor i cili përmbante të gjitha çështjet objekt vëzhgimi.

3.4 TAKIME ME PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE SHETËRORE

Takime me përfaqësues të gjykatave të rretheve gjyqësore përkatëse dhe aktorë të tjerë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve¹²

Me qëllim prezantimin e objektivave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve dhe kërkesën për bashkëpunim, gjatë muajit shtator 2006 KShH-ja mori takime me kryetarët e gjykatave të 7 rretheve gjyqësore në të cilat u shtri studimi, Tiranë, Shkodër, Fier, Elbasan, Gjirokastër, Korçë dhe Vlorë. Gjatë takimeve u diskutua metodologjia e punës dhe hapat që KShH-ja do të ndërmerre në vazhdim.

Kryetarët e gjykatave treguan mirëkuptim dhe i krijuan lehtësirat e nevojshme për kryerjen e këtij studimi.

4. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE

4.1 Veprimtari të përbashkëta në kuadër të respektimit të të drejtave të fëmijëve

Në kuadër të strategjisë kombëtare për fëmijët, 2005 – 2010, si dhe planveprimit të miratuar, Ministria e Brendshme zhvilloi disa takime me përfaqësues të OJF-ve, ndër të cilat edhe me KShH-në, duke kërkuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në takimet që OJF-të patën me Ministrinë e Brendshme, ranë dakord të përgatitnin një marrëveshje bashkëpunimi midis aktorëve si dhe të krijonin një grup teknik “Për të drejtat e fëmijëve” për të koordinuar aktivitetet në mbrojtje të lirive dhe të respektimit të të drejtave të të miturve si dhe të grupeve tematike, promovimin e tyre, parandalimin e tyre, parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale etj.

5. PROJEKTE TË REJA

¹¹ Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni “Soros” dhe CORDAID-i.

¹² Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni “Soros” dhe CORDAID-i.

5.1 “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”¹³

KShH-ja, si një organizatë me përvojë të gjatë në fushën e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të grupeve në nevojë, në veçanti, ka filluar zbatimin e projektit „Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”. Objektivi kryesor i projektit është dhënia e ndihmesës në rritjen e kujdesit ndaj fëmijëve me qëllim parandalimin e kontakteve të tyre me sistemin gjyqësor si dhe përmirësimin e trajtimit të tyre nga ky sistem, duke u udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Pjesë e projektit është lobimi pranë politikëbërësve dhe vendimmarrësve për një respektim më të mirë të interesit të lartë të fëmijës, duke nxitur edhe pjesëmarrjen e vetë të rinjve në këtë proces dhe të medias.

Për këtë do të bëhet vlerësimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me autor të veprës penale të miturin si dhe vlerësimi i ecurisë së proceseve gjyqësore ndaj të miturve. Shtirja kohore e vëzhgimit të proceseve me të mitur në gjykatat e rretheve Tiranë, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Elbasan dhe Fier do të jetë periudha 2005 dhe gjysma e vitit 2006.

KShH-ja do të japë rekomandimet dhe do të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për të përmirësuar trajtimin e të miturve në proces penal, për të minimizuar sa më shumë rrezikimin e të miturve.

6. TRYEZA DHE KONFERENCA

6.1 Takimi i katërt me OJF-të në fushën e emigracionit¹⁴

Në kuadër të rrjetit të OJF-ve në fushën e emigracionit, organizata ndërkombëtare IOM i bëri ftesë KShH-së për të bashkëpunuar në organizimin e takimit të katërt të OJF-ve që punojnë me çështjet e emigracionit. Pas disa takimesh koordinuese, më 15 shtator 2006, IOM-i, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, organizoi takimin e 4-t të rrjetit të OJF-ve të interesuara në fushën e migracionit me qëllim njohjen e veprimtarisë në këtë fushë dhe koordinimin e tyre.

KShH-ja bëri një prezantim të projektit “Për monitorimin e të drejtave të emigrantëve dhe të personave të kthyer”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth mundësisë së bashkëpunimit, shkëmbimit të informacioneve në mënyrë periodike mes aktorëve në këtë fushë, krijimin e grupeve të përbashkëta për përgatitjen e propozimeve ose të sugjerimeve të ndryshme, drejtuar autoriteteve shqiptare sipas përvojave të krijuara.

6.2 Seminar për monitorimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit rom në Shqipëri”

Në kuadër të projektit të nisur nga fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (Soros), në bashkëpunim me ekspertë të tij, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe të Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), në datën 5 korrik 2006 u organizua një seminar me qëllim paraqitjen e përfundimeve të monitorimit të strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit rom në Shqipëri”¹⁵. Monitorimi synoi analizimin

¹³ Ky projekt mbështetet financiarisht nga fondacioni „Soros” dhe CORDAID-i dhe do të zbatohet gjatë periudhës shtator 2006 – prill 2007.

¹⁴ Ky projekt është mbështetur financiarisht nga CORDAID-i dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

¹⁵ Projekti është mbështetur financiarisht nga fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (SOROS).

e përmbushjes së objektivave dhe të masave të parashikuara në strategji, të hapave konkretë të marra nga institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore dhe aktorë të tjerë në zbatim të saj. Fushat objekt monitorimi të strategjisë kombëtare për minoritetin rom ishin:

- 1) arsimi dhe edukimi;
- 2) trashëgimia kulturore dhe familja;
- 3) ekonomia, punësimi, ulja e varfërisë dhe mbrojtja sociale;
- 4) shëndetësia dhe infrastruktura si dhe rendi publik, drejtësia dhe administrata civile.

Gjatë zhvillimit të tryezës u paraqitën arritjet, problemet, të metat e konstatuara, arsyet e mosrealizimit të objektivave të parashikuar për përmirësimin e kushteve të jetesës të minoritetit rom si dhe u paraqitën rekomandimet përkatëse për organet e qeverisjes qendrore, vendore, për organizatat romë dhe organizatat e tjera që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, në këtë tryezë u theksua se, me gjithë ekzistencën e një baze ligjore pothuajse të mjaftueshme, zbatimi i strategjisë kombëtare për minoritetin rom ka hasur vështirësi të shumta dhe ka ecur me hapa të ngadaltë. Edhe arritjet kanë qenë të pakta dhe modeste. Në fund u bënë të njohura disa rekomandime për përmirësimet që duhen bërë për zbatimin me efikasitet të kësaj strategjie.

7. SHËTETASIT I DREJTOHEN KSHH-SË

7.1 Ankesat

Gjatë kësaj periudhe, në adresë të KShH-së kanë ardhur 61 ankesa, disa prej të cilave janë adresuar në institucione të ndryshme shtetërore. Për shumë prej tyre janë dhënë këshillime ose janë verifikuar sipas objektit të ankesave.

7.2 Raste të verifikuara nga KShH-ja

Përveç trajtimit të letrave dhe të ankesave të qytetarëve, KShH-ja ka verifikuar raste në të cilat pretendohet se ka pasur shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

- Në bazë të një sinjalizimi të marrë nga një gazetar i medias së shkruar pranë zyrës së KShH-së, në datën 7 korrik 2006, KShH-ja realizoi një mision vëzhgimi në institucionin e paraburgimit nr. 313, Tiranë. Qëllimi i tij ishte verifikimi i rastit të një të mituri ndaj të cilit pretendohet se shokët e tij të qelisë e kishin keqtrajtuar dhe kishin abuzuar me të seksualisht. Grupi i vëzhgimit të KShH-së mori takim të drejtpërdrejtë me të paraburgosurin e mitur dhe me drejtuesit e institucionit të paraburgimit nr. 313, Tiranë. Pas verifikimit, grupi i vëzhgimit të KShH-së u rekomandoi me shkrim drejtuesve të institucionit të paraqitnin një letër informuese pranë prokurorisë së gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, ku të kërkonin edhe ekspertimin psikiatrik të të paraburgosurit të mitur për shkak të gjendjes së rëndë psikike të tij. Gjithashtu, u rekomandoi të merrnin masat e nevojshme për t'i siguruar të miturit trajtimin e veçantë mjekësor në spitalin e burgut.
- Në datën 26 korrik 2006, bazuar në një artikull në median e shkruar (Gazeta “Panorama”) të datës 25 korrik 2006, KShH-ja realizoi një mision sporadik vëzhgimi në spitalin ushtarak dhe në spitalin e burgut. Qëllimi i këtij vëzhgimi ishte verifikimi i rastit të të dënuarit D.S., i cili kishte konsumuar një sasi ilaçesh për t'u vetëhelmuar. Nga takimi me mjekun e repartit toksikologjik rezultoi se të dënuarit i ishte dhënë ndihma mjekësore e nevojshme për helmim, por problemi qëndronte se ai vuante nga probleme psikike. KShH-ja e ka trajtuar edhe më parë këtë rast. Duke parë veprimet e njëpasnjëshme të këtij të dënuari për vetëvrasje dhe duke qenë se ai paraqet rrezikshmëri, si për vetveten, ashtu edhe për administratën e burgut të Peqinit ku aktualisht vuan dënimin me burgim, KShH-ja i dërgoi një letër informuese drejtorit të Përgjithshëm të Burjeve me qëllim marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që ky i dënuar të mos tentojë përsëri të vetëvritet e për ta mbajtur atë nën mbikëqyrje dhe trajtim të vazhdueshëm nga ana e një mjeku psikiatër.
- Në bazë të një njoftimi në median televizive për protestën e të paraburgosurve të komisarit të policisë në Berat për shkak të keqtrajtimit të tyre nga ana e personelit të institucionit, në datën 11 shtator 2006, KShH-ja realizoi një mision sporadik vëzhgimi në këtë institucion. Nga vëzhgimi i kryer rezultoi se të paraburgosurit e këtij komisarati nuk ishin në protestë, por, për shkak të një incidenti, në një nga dhomat e paraburgimit kishte rënë zjarr. Në takimet me grupin e vëzhgimit të KShH-së të paraburgosurit ngritën sërish shqetësimin për të mos lejuar zbatimin në dhomat e paraburgimit të Rregullores së Ministrisë së Rendit, të dhjetorit 1999, e cila cenon rëndë të drejtat dhe liritë e tyre. Këtë shqetësim të tyre KShH-ja ua ka bërë disa herë të njohur institucioneve përgjegjëse shtetërore për ta shfuqizuar këtë rregullore e cila vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor shqiptar si dhe me standardet ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të të paraburgosurve. Të paraburgosurit, gjithashtu edhe drejtuesit e këtij institucioni, kërkuan, si të domosdoshme në kushtet ku ata jetonin, praninë e psikologut në dhomat e paraburgimit. Të paraburgosurit nuk shprehën ndonjë pakënaqësi nga trajtimi që i bëhej nga personeli i institucionit.
- Në bazë të një informacioni të marrë në datat 7 dhe 22 shtator 2006, KShH-ja realizoi vëzhgime në institucionin e paraburgimit nr. 302, Tiranë. Qëllimi i këtyre vëzhgimeve ishte verifikimi i ndalimit dhe i arrestimit të katër të paraburgosurve homoseksualë. Në kontaktet me këta të paraburgosur ata u shprehën se në procedurën e ndalimit dhe të arrestimit të tyre kishte pasur disa shkelje procedurale të të drejtave të njeriut, të tilla si: mosnjoftimi i tyre për të pasur një mbrojtës, mosnjoftimi për arsyet dhe motivet e

arrestimit, mosmarrja në pyetje nga prokurori i çështjes si edhe mungesa e kontakteve me avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata për t'i informuar për procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes së tyre. Grupi i vëzhgimit i informoi të paraburgosurit për të drejtat dhe detyrat e tyre ligjore. Menjëherë pas ndërhyrjes së KShH-së në prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, ndaj tyre u morën masa të menjëhershme. Prokurori i çështjes mori takim me këta të paraburgosur, i njohu ata me akuzën si dhe ndryshoi mbrojtësin ligjor për një përfaqësim më të mirë të tyre në gjykatë.

- Në datën 22 shtator 2006, KShH-ja realizoi një mision vëzhgimi në institucionin e paraburgimit nr. 302, Tiranë. Nga ky vëzhgim rezultoi se dy nga të paraburgosurit e këtij institucioni vuanin nga tuberkulozi. U morën takime të drejtpërdrejta me mjekun e institucionit dhe të paraburgosurit. Në fund të monitorimit, KShH-ja i rekomandoi Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve transferimin e dy të paraburgosurve të sëmurë në një spital të specializuar për të pasur trajtimin e duhur mjekësor. KShH-ja theksoi, gjithashtu, se mbajtja e të paraburgosurve të sëmurë në kushtet e institucionit të paraburgimit së bashku me persona të tjerë, në mjedise të paajrosura, përbën rrezik jo vetëm për shëndetin e tyre, por edhe për të paraburgosurit e tjerë. Menjëherë pas ndërhyrjes së KShH-së, u morën masa konkrete për transferimin e këtyre të paraburgosurve në spitalin e specializuar ku i janë nënshtruar një terapie mjekësore të veçantë.
- Në datën 26 shtator 2006, KShH-ja kreu një vëzhgim në burgun e Lezhës për të verifikuar një ankese telefonike për ushtrim dhune ndaj një të dënuari nga ana e personelit të burgut. Nga vëzhgimi i kryer, si edhe nga kontaktet me të dënuarin për të cilin pretendohet të ishte keqtrajtuar ngaqë gjatë një kontrolli në dhomën e tij ishin gjetur sende të ndaluara me ligj, grupi i vëzhgimit nuk arriti të verifikojë pretendimet dhe përdorimin e dhunës.

8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës korrik – shtator 2006, KShH-ja, nëpërmjet 4 deklaratave publike, ka reaguar për probleme të vëzhguara në vendet e paraburgimit, për masat që duhen marrë për reformën zgjedhore dhe për çështjen e emigrantëve¹⁶.

9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHETËRORE DHE ORGANIZATA TË TJERA

KShH-ja ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore¹⁷, kryesisht për trajtimin e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së, për paraqitjen e problematikës së dalë nga vëzhgimi, për dhënien e rekomandimeve të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike etj.

Gjatë kësaj periudhe, KShH-ja ka komunikuar me Ministrinë e Brendshme, prokuroritë e rretheve gjyqësore të Elbasanit, Fierit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Drejtësisë etj.

10. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

¹⁶ Për më gjerë, shih shtojcën nr. 1

¹⁷ Gjatë periudhës prill-qershor 2006 ka pasur 46 letra dalëse dhe 10 letra hyrëse.

10.1 Përgatitja e planit strategjik dhe biznesplani i KShH-së - 2007 - 2010

Përmirësimi i përshkrimeve të punës, si pjesë e planit strategjik 2007 – 2010

Në kuadër të planit strategjik që KShH-ja po përgatit për periudhën 2007 – 2010, u punuan dy çështje të zhvillimit të brendshëm të organizatës dhe, konkretisht: profilet, përshkrimet e punës dhe proceset e punës.

Në këtë proces stafi i KShH-së është asistuar nga organizata ndërkombëtare SNV (Connecting People's Capacities). Ky proces është në vazhdimësi.

10.2 NGRITJE E KAPACITETEVE TË KSHH-SË

TRAJNIME

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit të KShH-së, gjatë periudhës 27-30 shtator 2006, u organizua një trajnim trajnerësh për avokatinë në fushën e minoriteteve. Metodologjia interaktive u mundësoi pjesëmarrësve të mësonin më shumë për trajnimin në fushën e minoriteteve dhe, në të njëjtën kohë, të shkëmbejnë përvojë nga organizatat që ata përfaqësonin. Në këtë trajnim morën pjesë K. Alikaj dhe E. Saliu. Trajnimi u ofrua nga Qendra për Rritjen e Zhvillimit Njerëzor.

REKRUTIM I STAFIT TË RI NË KSHH

Për të koordinuar projektin “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer”, KShH-ja organizoi një konkurrim të hapur për koordinimin e këtij projekti. Pas kërkesave të marra dhe intervistave, koordinatori i këtij projekti u emërua Andi Pipero, jurist.

ANEKS NR.1 - DEKLARATA

1. Shërbimi shëndetësor në burgje vazhdon të mbetet problem i pazgjidhur

Tiranë, më 13 korrik 2006

Gjatë periudhës Maj-Korrik 2006, një grup ekspertësh të KSHH-së realizuan vëzhgime në disa Institucione të Ekzekutimit të Dënimeve Penale¹⁸ me qëllim monitorimin e respektimit të të drejtave të personave që vuajnë dënimin me burgim dhe në veçanti të trajtimit të të dënuarve të sëmure dhe ofrimin e shërbimit mjekësor në këto institucione.

Gjatë vëzhgimeve rezultoi se, në krahasim me periudhën Nëntor 2005-Janar 2006 kur KShH-ja ndërmoi disa vëzhgime, janë ndërmarrë hapa pozitivë¹⁹. Në Spitalin e Burgut ishte vënë në përdorim të plotë laboratorin dhe shërbimi ambulator; në institucionin e paraburgimit nr. 302 Tiranë ishin kartelizuar të paraburgosurit dhe ishin vendosur lidhje me Institutin e Higjenes për të bërë analizat për hepatitin C dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Megjithatë, gjatë vëzhgimeve të kryera vihen re disa probleme shqetësuese ende të pazgjidhura si:

1 **Furnizimi me medikamente dhe pajisje mjekësore.** Gjendja aktuale në këto institucione²⁰ bie ndesh me kërkesat e ligjit Nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” neni 26 “Shërbimi shëndetësor” ku thuhet se “Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore”.

2 Të dënuarit duhet t’u krijohet mundësia **për konsulta me specialistë (kardiolog, endokrinolog, neurolog, etj)** në Spitalin e Burgut.

3 **Gjendja e të sëmureve mendorë.** Trajtimi i tyre përbën shkelje flagrante dhe mosrespektim të disa akteve ligjore, përkatësisht:

- a. Neni 82, pika 1 e dokumentit të Kombeve të Bashkuara “Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve”, i cili sanksionon se “*personat me të meta mendore nuk duhet të mbyllet në burgje; se duhet të merren masa për t’i transferuar ata sa më shpejt që të jetë e mundur, në institucione për të sëmure mendorë;*
- b. Ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale”, sipas të cilit “*masat mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohen në institucionin mjekësor të specializuar...*” (neni 45).
- c. Ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku thuhet se “*Personat e sëmure ose me shqetësime mendore dhe psikike vendosen në institucione mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve që shërbejnë për mjekimin e tyre*” (neni 16).

KSHH i bën thirrje Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që në bazë të ligjit të marrin masat e mëposhtme:

1. Të zgjidhë problemin e furnizimit me ilaçe dhe pajisje mjekësore për të gjitha institucionet e paraburgimit dhe burgjet në varësi të këtyre institucioneve;

¹⁸ Përkatësisht institucionet e vëzhguara janë: burgu nr. 325, Spitali i Burgut dhe institucionet e paraburgimit nr. 313 e 302 në Tiranë.

¹⁹ Në përfundim të vëzhgimeve, KSHH ka dalë me një deklaratë për shtyp “Mungesa e respektimit të të drejtave të sëmureve mendorë në burgun e Krujës”. Shih deklaratën e KSHH-së, datë 03.03.2006 dhe letrën zyrtare drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të datës 09.01.2006.

²⁰ Kjo situatë rezultoi në institucionet e paraburgimit nr. 313 dhe 302 dhe në Spitalin e Burgut në Tiranë.

2. Të merren masa për trajtimin e specializuar të sëmurëve kronikë, me sëmundje fizike ose mendore dhe të sigurohen medikamentet e nevojshme për ta;
3. Të merren masa për një trajtim të specializuar të grave të paraburgosura dhe të dënuara, duke ofruar shërbime të nevojshme për to si dhe të bëhen depistime (kolposkopi, eko, mamografi dhe vizitë gjinekologjike).
4. Të shpejtohen veprimet për fillimin e funksionimit të qendrës për të sëmurët në qytetin e Durrësit dhe të bëjnë transferimin pranë saj të personave që kanë nevojë për një trajtim të specializuar.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreson që Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të trajtojë me seriozitet problemet e mësipërme si dhe të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e tyre sipas kërkesave të ligjit në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

2. Zgjedhjet e ardhshme në udhëkryq

Tiranë, më 21 Korrik 2006

Duke u mbështetur në faktin se sipas pikës 8 të nenit 7 të Kodit Zgjedhor “Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zhvillohen 60 deri 30 ditë para mbarimit të mandatit të organeve vendore ekzistuese...” dhe duke patur parasysh mbarimin e mandatit të tyre, **zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore duhet të zhvillohen gjatë periudhës 20 dhjetor 2006-20 Janar 2007.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vëren me shqetësim se:

- **Komisioni parlamentar i ngritur posaçërisht për reformën zgjedhore rezulton të ketë mbetur një strukturë formale. Nuk është hedhur asnjë hap përpara në diskutimin e çështjeve për zgjidhjen e të cilave ai është krjuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë.**
- **Ende nuk është marrë në shqyrtim asnjë rekomandim i OSBE/ODIHR-it për përmirësime në Kodin Zgjedhor.**
- **Megjithëse kanë kaluar afatet ligjore, institucionet kushtetuese ende po vonojnë në plotësimin e vendeve vankante në KQZ.**

Konstatohet se kjo situatë e krijuar është pasojë e mungesës së vullnetit të dy forcave më të mëdha parlamentare për të gjetur konsensusin e nevojshëm për realizimin e reformës zgjedhore.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e konsideron këtë gjendje tepër serioze dhe mjaft shqetësuese. Për shkak të këtyre vonesave të patolerueshme po vihet në pikëpyetje zhvillimi i zgjedhjeve brenda afateve ligjore duke rrezikuar garantimin e zhvillimit të tyre sipas standardeve ndërkombëtare të lira, të ndershme, demokratike dhe të pakontestuar.

Gjendja bëhet edhe më shqetësuese po të mbahet parasysh se së shpejti, sipas parashikimeve kushtetuese, punimet e Kuvendit ndërpriten për filluar në ditët e para të muajit shtator 2006. KSHH vëren se mes dy partive të mëdha parlamentare nuk janë dhënë sinjale pozitive për zhvillimin e një dialogu konstruktiv me synim kapërcimin e kësaj shtate, pasojat e së cilës mund të kenë një ndikim negativ në procesin e ratifikimit të Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit nga vendet anëtare të Bashimit Evropian.

Ndër të tjera, kjo vonesë e theksuar e bën të pamundur respektimin e afateve ligjore që përcakton Kodi Zgjedhor lidhur me përgatitjen dhe shpalljen e listave të zgjedhësve, ngritjen e KZQV-ve, etj.

KSHH është i shqetësuar për faktin se mosmarrja parasysh e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, mund të krijojë terren për lindjen e pakënaqësive dhe kontestimeve gjatë procesit zgjedhor ose për rezultatin e tyre nga njëra ose tjetra palë politike.

Sa më sipër KSHH:

- *I bën thirrje të gjitha partive politike, kryesisht dy partive më të mëdha, për të arritur në një kompromis për zgjidhjen me konsensus të çështjeve të ngritura apo të kontestuara.*
- *I drejtohet Presidentit të Republikës që në funksion të kompetencave të tij kushtetuese, të ndikojë në kapërcimin e menjëhershëm të kësaj gjendjeje, duke u kërkuar njëkohësisht institucioneve kushtetuese të përmbushin pa vonesa të mëtejshme detyrimin ligjor për plotësimin e vendeve vakante në KQZ.*
- *I sugjeron Prezencës së OSBE-së në Tiranë që në përputhje me misionin e saj, të nxisë frymën e një diskutimi konstruktiv mes palëve duke synuar realizimin e reformës zgjedhore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.*

3.Gjendje e rëndë në vendet e paraburgimit Vlorë, Fier dhe Lushnje

Tiranë, më 14 Korrik 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadër të monitorimeve të filluara në vendet e paraburgimit, në datat 10-12 Korrik 2006, kreu vëzhgime në vendet e paraburgimit Vlorë, Fier dhe Lushnje. Në përfundim të këtyre vëzhgimeve rezultoi se:

1. **Infrastruktura e institucioneve të vëzhguara ishte tejet e amortizuar.** Pajisjet, krevatët, dyshekët, çarçafët ishin të vjetëruara. **Kushtet higjieno-sanitare ishin tejet të rënda dhe pajisjet dhe çarçafët e papastër. Një pjesë e mjeteve higjieno-sanitare siguroheshin nga familjarët e të paraburgosurve.** Kjo gjendje vjen në kundërshtim me Rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 3750/2, datë 23.07.2003 “Për organizimin e funksionimin e sistemit të paraburgimit”.
2. **Norma e ushqimit e personave të paraburgosur ishte nën nivelin e pranueshëm. Përmbajtja e tij nuk kontrollohej nga mjeku.** Një gjendje e tillë bie ndesh me nenet 17 dhe 19 të Rregullores së mësipërme.
3. **Në paraburgimin e Lushnjes dhe të Vlorës mungonte mjeku.** Kjo gjendje vjen në kundërshtim me nenin 29 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim” dhe nenet 21- 23 të Rregullores së mësipërme.
4. **Në vendet e paraburgimit vazhdon mbipopullimi** edhe pse në këtë drejtim vërehen përmirësime. Është shqetësues fakti se në paraburgimin e Vlorës vazhdojnë të jenë 37 të paraburgosur mbi kapacitet, në atë të Fierit 40 persona, ndërsa në komisariatet e Lushnjes 24 persona. **Një gjendje e tillë sjell keqtrajtimin e të paraburgosurve dhe shkakton çënime të rënda të drejtave të tyre si mungesën e klasifikimit të persona të paraburgosur sipas grupmoshave, llojeve të veprave penale të kryera si edhe veçorive intelektuale dhe psikike të tyre etj.** Kjo situatë çënon nenin 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Ndalimi i torturës”, nenin 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkesat e ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” si edhe Rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 3750/2, datë 23.07.2003 “Për organizimin e funksionimin të sistemit të paraburgimit”. **Gjithashtu, shqetësues paraqitet fakti që në çdo qeli gjendeshin 8 deri në 10 persona, duke mos plotësuar kështu kërkesat ligjore lidhur me sipërfaqet e banimit, kubaturat si dhe sistemin e ajrimit me qëllim sigurimin e një jete sa më normale.**
5. Vlen të përmendet fakti se **të miturit nuk ishin vendosur në një seksion të veçantë nga të rriturit.** Kjo bie ndesh me standartet ndërkombëtare dhe kërkesat e ligjit shqiptar sipas të cilit të miturit mbahen veçmas nga të rriturit e paraburgosur.

6. Në paraburgimet e Drejtorisë së Policisë Fier dhe të Komisarariatit Lushnje kishte 7 të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. Mbjajta e tyre është shkelje e rëndë e ligjit Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Per ekzekutimin e vendimeve penale”.
7. Në institucionet e vëzhguara kishte mungesa totale të medikamenteve mjekësore. Gjithashtu, nuk ekzistonte shërbimi stomatologjik. Këto mungesa bien ndesh me nenin 21 të Rregullores së Ministrisë së Drejtësisë që kërkon shërbim shëndetësor, vizita mjekësore, shërbim stomatologjik për të paraburgosurit.
8. Personave të paraburgosur që qëndrojnë në vendet e paraburgimit në Fier dhe Lushnje u ndalohej mbajtja e stilolapsave, radiove, gazetave, librave etj.

Megjithëse Komiteti Shqiptar i Helsinkit disa herë ka evidentuar faktin se **Rregullorja Nr.1075, datë 15.09.1999 e miratuar nga Ministria e Brendshme duhej shfuqizuar, aq më tepër mbas miratimit të Rregullores së Ministrisë së Drejtësisë Nr.3750/2, datë 23.07.2003 “Për organizimin e funksionimin e sistemit të paraburgimit”, ajo ende vazhdon të zbatohet. Si pasojë, cënohen rëndë të drejtat e të paraburgosurve.**

Vlen të theksohet se në nenin 75, të ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998, “Mbi të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” thuhet se: **“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve duke respektuar kufizimet e vendosura për ta me ligje të tjera”**. Kjo do të thotë se asnjë kufizim lidhur me të drejtat e të paraburgosurve nuk mund të vendoset me Rregullore.

Duke marrë shkas nga konstatimet e këtij vëzhgimi, **Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme t’i drejtohet përsëri Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që të marrin masa urgjente për përmirësimin sa më të shpejtë të gjendjes, gjë që do të ndihmonte në respektimin e të drejtave të të paraburgosurve në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dokumentat ndërkombëtare dhe do t’i japë fund shkeljeve të konstatuara.**

4. Komiteti Shqiptar i Helsinkit fillon projektin një vjeçar të monitorimit të respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të kthyer

Tiranë, më 24 korrik 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja) vëzhgon respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe reagon për rivënien e tyre në vend; sensibilizon shtetasit për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tyre; ndihmon në përmirësimin e legjislacionit dhe të praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave e rekomandimeve gjatë hartimit dhe më pas në zbatimin e tij. Misioni i KShH-së përfshin edhe respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë kudo që ata ndodhen.

KShH-ja në bashkëpunim me Monitoruesin Grek të Helsinkit edhe më parë kanë monitoruar dhe verifikuar respektimin e shkeljeve të të drejtave të emigrantëve shqiptarë, veçanërisht në kufirin Shqipëri – Greqi.

Duke filluar nga muaji qershor 2006, KShH-ja ka filluar zbatimin e një projekti një vjeçar për vëzhgimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të kthyer, sipas marrëveshjes së ripranimit.

Grupi synues i këtij projekti do të jenë qytetarët shqiptarë të kthyer nga vende të tjera në Shqipëri, respektimi i të drejtave të tyre, evidentimi i rasteve të shkeljeve të të drejtave të tyre nga autoritetet shtetërore shqiptare kufitare dhe atyre të vendeve fqinje, ose nga struktura të tjera shtetërore në Shqipëri dhe jashtë saj.

Disa nga objektivat kryesorë të projektit do të jenë:

- ☞ Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer në kuadrin e marrëveshjes së ripranimit;

- ☞ Vëzhgimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga autoritetet shtetërore shqiptare sidomos ato kufitare;
- ☞ Bashkëpunimi me median shqiptare përsa i përket çështjeve të informimit dhe trajtimit të çështjeve në fushën e emigrimit dhe respektimit të të drejtave të shtetasve shqiptarë;
- ☞ Të kontribuojmë në vëzhgimin e të drejtave të emigrantëve në Shqipëri dhe jashtë saj dhe në trajtimin e tyre në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Projekti në shumën 46990 Euro mundësohet me mbështetjen financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit dhe do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me aktorët kryesorë në këtë fushë dhe me organizatat simotra në vendet e tjera, sidomos me Monitoruesin Grek të Helsinkit dhe organizatat e emigrantëve jashtë vendit.